



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.211, datë 08.10.2024

PËR

**“KOMANDIMIN E PROKURORIT YLLI PJETËRNIKAJ SI PEDAGOG I BRENDSHËM PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 53 pika 1 dhe 2, 54 dhe 57 pika 2 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 184, germa “d”, dhe 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Komandimin e prokurorit Ylli Pjetërnikaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si pedagog i brendshëm pranë Shkollën e Magjistraturës.
2. Ndërprerjen e komandimit si këshilltar ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të prokurorit Ylli Pjetërnikaj, miratuar me vendimin nr. 375, datë 30.11.2023.
3. Afati i komandimit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të jetë 2 (dy) vjet dhe fillon nga data 09.10.2024.
4. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Ylli Pjetërnikaj, Prokurori i Përgjithshëm, Shkolla e Magjistraturës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit. U shpall në Tiranë, më 08.10.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Olger Eminaj

ANËTAR  
Arta Mandro

ANËTAR  
Erind Gërmenji

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Ledina Riza

ANËTAR  
Erind Merkuri